

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Kualifikimin Profesional

MEKANIKË

Niveli IV i KSHK¹, referuar nivelit IV në KEK²

(1 vjeçar)

Kodi: F-IV-25

Miratoi:

MINISTRI

1.Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
2.Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Tiranë, 2025

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Mekanikë”, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), 1 vjeçar.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK.

1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK.
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK.
3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK.

III. Plan i mësimor për kualifikimin profesional “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK.

IV. Udhëzime për planin mësimor.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Programi orientues i provimit përfundimtar

I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me sektorin e mekanikës si dhe për të vijuar arsimin dhe formimin në nivele më të larta”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt formimit profesional dhe arsimit të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe menaxhuese, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale dhe akademike;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin profesional “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në kualifikimin “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në një nga kualifikimet e nivelit III të KSHK të drejtimin mësimor “Mekanikë”;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MEKI përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efëçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse e menaxhuese për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll dhe përshtatshmëri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në njërin nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të hartojë një plan-bisnesi, që lidhet me veprimtaritë profesionale në sektorin e mekanikës.
- Të kryejë llogaritje ekonomike, që lidhen me veprimtaritë profesionale në sektorin e mekanikës.
- Të organizojë punën gjatë veprimtarisë profesionale në sektorin e mekanikës.
- Të kryejë menaxhimin e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare gjatë veprimtarive profesionale në sektorin e mekanikës.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacion, që lidhet me veprimtaritë profesionale në sektorin e mekanikës.
- Të zbatojë bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale në sektorin e mekanikës.
- Të zbatojë standartet teknike që veprojnë në sektorin e mekanikës.
- Të zbatojë parimet e etikës gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale në sektorin e mekanikës.
- Të projektojë nyje të thjeshta mekanike.
- Të kryejë llogaritjet konstruktive për proceset e prodhimit në mekanikë.
- Të kryejë projektimin konstruktiv të detalit dhe llogaritjen projektuese.
- Të interpretojë rëndësinë e programeve kompjuterike për punime me makina me drejtim të programuar numerik.
- Të përzgjedhë gjysmë-fabrikatin dhe të përcaktojë shtresat e punimit.
- Të përcaktojë radhën së punimeve në proceset e prodhimit në mekanikë.
- Të përcaktojë regjimeve të punës për punimin e detalit.
- Të përgatitë kartën teknologjike.
- Të interpretojë rëndësinë e automatizimit dhe përdorimet e tij në proceset e prodhimit në mekanikë.
- Të interpretojë rëndësinë PLC-të (Programming logic controller) dhe përdorimet e tyre në

proçeset e prodhimit në mekanikë.

- Të interpretojë lidhjet (bashkimet) e detaleve, llojet, veçoritë, përdorimi.
- Të interpretojë ndërtimin e transmiseve dhe funksionimin e tyre sipas llojit përkates.
- Të kryejë llogaritjet e transmiseve sipas llojit të tyre.
- Të kryejë diagnostikimin e parregullsive në pajisje dhe konstruksione të ndryshme mekanike.
- Të kryejë punimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në pajisjet elektromekanike.
- Të kryejë në pajisjet hidropneumatike.
- Të kryejë diagnostikime të sistemeve hidropneumatike.
- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit për qëllime të veprimtarive në sektorin e mekanikës.
- Të përdorë programet *CAD-CAM* për vizatimin me kompjuter dhe programimin e procesit të prodhimit të detaleve në makina me drejtim të programuar numerik *CNC*.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës.
- Të kryejë projektimin e procesit teknologjik dhe prodhimin e nyjeve të thjeshta mekanike.
- Të kryejë diagnostikimin e parregullsive në pajisje dhe konstruksione të ndryshme mekanike.
- Të kryejë saktë veprimet për të dhënë ndihmën e shpejtë për të dëmtuarit në punë.
- Të zbatojë teknikat e komunikimit efektiv gjatë punës.
- Të zbatojë kodin e etikës gjatë punës.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtijshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Mekanik”, Niveli IV i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Mekanik”, Niveli IV i KSHK, e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Çertifikatën e teknikut në mekanikë. Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje private/shtetërore dhe veprimtari profesionale për prodhime, montime, mirëmbajtje dhe riparime mekanike, si teknik i mesëm.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.

III. Plani mësimor për kualifikimin profesional “Mekanik”, Niveli IV i KSHK.

Plani mësimor për kualifikimin profesional “Mekanik”, Niveli IV i KSHK.			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ vjetore
			Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	15/16 (480/512)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)

5		Matematikë	2
6		Fizikë	1
7		Biologji	2
8		Shkenca sociale	1
9		Histori	1
10		Gjeografi	1
11		Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)	1
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	2
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	9 (288)
1	L-17-157-22	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-05-198-24	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	1
3	L-04-756-25	Planifikimi dhe organizimi i punës në mekanikë	2
4	L-04-757-25	Proceset e prodhimit në mekanikë	2
5	L-04-304-25	Detale makinash	2
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	6 (192)
1	M-04-2212-25	Prodhimi me cilësi i produkteve mekanike	64
2	M-04-871-25	Punime të diagnostikimit në pajisjet dhe konstruksionet mekanike	64
3	M-04-2213-25	Mirëmbajtje dhe riparime mekanike	32
4	M-38-2214-25	Komunikimi dhe etika profesionale në mekanikë	32
		Gjithsej A+B+C	30/31 (960/ 992)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK, përbëhet nga 3 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave profesionale dhe menaxheriale, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja

e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i personelit mësimdhënës e drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të kualifikimit profesional “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Rekomandohet përdorimi i metodës së “*lojës me role*”, ku nxënësve tu jepen përgjegjësi në kryerjen e funksioneve menaxhuese dhe drejtuese.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të kualifikimit profesional “Mekanikë”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet përfundimtare.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në kualifikimin profesional “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale si dhe Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar, sipas Udhëzimeve të MEKI.

VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Mekanikë”, Niveli IV i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Mekanikë”, niveli III, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Çertifikatën teknikut në mekanikë, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modeleve të miratuara nga MEKI, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale të klasës 13-të;

- rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale dhe të Praktikës Profesionale të Integruar.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-22). Kl. 13 – 64 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- të analizojnë veçoritë e etikës dhe komunikimit në kontekstin e veprimtarisë së bizneseve
- të bëjnë vlerësimin e mundësive dhe rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit
- të përshkruajnë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi
- të zbatojnë procedurat e regjistrimit dhe përshkruajnë fazat e zhvillimit të biznesit
- të konceptojnë strukturën organizative dhe përshkrimet e punës së personelit të një biznesi
- të përshkruajnë veçoritë e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore të një biznesi
- të analizojnë aspektet e buxhetimit të një biznesi
- të kryejnë llogaritje ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi
- të llogarisin kostot dhe çmimet e produkteve e shërbimeve të një biznesi
- të analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes
- të analizojnë rolin dhe teknikat e e-sipërmarrjes në veprimtarinë e bizneseve.
- të përshkruajnë dhe simulojnë veprimet individuale me bankat, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet.
- të analizojnë llojet e siguracioneve personale dhe veprimet që kryhen me to.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 64 orë

Tema 1	Etika dhe komunikimi në biznes	4 orë
Tema 2	Konceptimi i idesë së biznesit, vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve	6 orë
Tema 3	Hartimi i planit të biznesit	6 orë
Tema 4	Procedurat e regjistrimit të biznesit	6 orë
Tema 5	Struktura organizative dhe personeli i biznesit	5 orë
Tema 6	Planifikimi, rekrutimi, seleksionimi e zhvillimi i burimeve njerëzore	6 orë
Tema 7	Kostimi dhe çmimi i produkteve dhe shërbimeve	4 orë
Tema 8	Kontabiliteti financiar në kuadrin e biznesit	6 orë
Tema 9	Buxhetimi në biznes	4 orë
Tema 10	Marketingu dhe shitjet në biznes	9 orë
Tema 11	E – sipërmarrja	2 orë
Tema 12	Veprimet individuale me bankat	3 orë
Tema 13	Siguracionet personale	3 orë

2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-24). Kl.13 – 32 orë

- Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
- Të shpjegojnë objektivat për zhvillim të qëndrueshëm.
- Të shpjegojnë kuptimin për aftësitë e gjelbra në një ekonomi të gjelbër.
- Të shpjegojnë rëndësinë e aftësive digjitale në përballimin e sfidave globale.

- Të analizojnë mjedisin dhe komponentët e tij.
 - Të shpjegojnë ekosistemet dhe biodiversitetin.
 - Të analizojnë ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre.
 - Të shpjegojnë burimet natyrore të ripërtëritshme dhe jo të ripërtëritshme.
 - Të përshkruajë mënyrën e shpjegimit të të dhënave mjedisore.
 - Të shpjegojnë rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve, riciklimi dhe zgjidhjet digjitale.
 - Të shpjegojnë kuptimi i cikleve të jetës së produktit dhe krijimi i mbetjeve.
 - Të përshkruajnë parimet bazë të ekonomisë qarkulluese.
 - Të shpjegojnë proceset dhe teknologjitë e riciklimit.
 - Të shpjegojnë dhe japin shembuj nga drejtimet profesionale mbi reduktimi, ripërdorimi dhe riciklimin.
 - Të hulumtojnë mbi platformat digjitale për programet e menaxhimit të mbetjeve.
 - Të shpjegojnë optimizimin e proceseve të riciklimit duke përdorur teknologjinë.
 - Të shpjegojnë avantazhet e zgjidhjeve digjitale për mirëmenaxhimin e mbetjeve.
 - Të shpjegojnë rëndësinë e ruajtja, menaxhimi dhe monitorimi digjital të burimeve ujore në drejtimet profesionale përkatëse.
 - Të përshkruajë praktikën e qëndrueshme të menaxhimit të ujit në fushën profesionale përkatëse.
 - Të dallojë dhe përdorë sistemet digjitale të monitorimit të përdorimit dhe cilësisë së ujit.
 - Të shpjegojnë teknologjitë inteligjente për menaxhimin e qëndrueshëm të ujit.
 - Të përshkruajë transportin e qëndrueshëm, lëvizshmëria e zgjuar dhe zgjidhjet digjitale në drejtimet profesionale përkatëse.
 - Të dallojë opsionet alternative të transportit (p.sh., transporti publik, biçikleta, ecje) si dhe përdorimin e mjeteve elektrike në veprimtari të ndryshme profesionale.
 - Të dallojë platformat digjitale për transport të qëndrueshëm si dhe Integrimin e teknologjive inovative në sistemet e transportit publik.
 - Të shpjegojnë kuptimin dhe rëndësinë mbi konsumin e qëndrueshëm, tregun digjital dhe marketingun digjital.
 - Të dallojë praktikën etike të konsumit, zgjedhjet e konsumatorëve dhe ndikimet e tyre mjedisore.
 - Të shpjegojnë praktikën dhe platformën e qëndrueshme të tregtisë elektronike si dhe kuptimin për marketingun digjital për promovimin e produkteve eko-miqësore.
 - Të përshkruajnë modele të qëndrueshme biznesi bazuar në praktikën e ekonomisë së gjelbër dhe digjitalet shpjegojnë politikat për zhvillim të qëndrueshëm në fusha të ndryshme profesionale.
 - Të shpjegojnë konsideratat etike në qeverisjen digjitale për qëndrueshmëri.
- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13 - 32 orë**

Tema 1	Zhvillimi i qëndrueshëm	3 orë
Tema 2	Bazat e shkencës mjedisore	3 orë
Tema 3	Menaxhimit të mbetjeve, riciklimi dhe zgjidhjet digjitale	6 orë
Tema 4	Ruajtja, menaxhimi dhe monitorimi digjital i burimeve ujore	4 orë
Tema 5	Transporti i qëndrueshëm, lëvizshmëria e zgjuar dhe zgjidhjet digjitale	4 orë
Tema 6	Konsumi i qëndrueshëm, tregu digjital dhe marketingu digjital	4 orë
Tema 7	Sipërmarrja e gjelbër, inovacioni dhe modelet digjitale të biznesit	4 orë
Tema 8	Politika dhe qeverisja për zhvillim të qëndrueshëm	4 orë

3. Lënda “Planifikimi dhe organizimi i punës në mekanikë” (L-04-756-25). Kl. 13 – 64 orë

- Synimet e lëndës “Planifikimi dhe organizimi i punës në mekanikë”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Planifikimi dhe organizimi i punës në mekanikë”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë veçoritë e degës së mekanikës dhe të sipërmarrjeve që veprojnë në këtë sektor.
- Të përshkruajnë organigramën e një ndërmarrjeje mekanike.
- Të shpjegojnë mënyrën e organizimit të ndërmarrjes/ repartit të prodhimit industrial.
- Të argumentojnë mënyrën e vendosjes së makinerive dhe pajisjeve në repartin e prodhimit.
- Të përshkruajnë linjat e prodhimit dhe llojet e tyre.
- Të analizojnë, sipas standardeve, projektet, vizatimet dhe skicat.;
- Të shpjegojnë radhën e punës sipas procesit të prodhimit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e planifikimit dhe përzgjedhjes së mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të punës.
- Të shpjegojnë rëndësinë e planifikimit dhe përzgjedhjes së materialeve dhe pjesëve të këmbimit, sipas përdorimit dhe karakteristikave të tyre.
- Të shpjegojnë rëndësinë e planifikimit dhe përzgjedhjes së burimeve njerëzore të nevojshme sipas kompetencave profesionale.
- Të përshkruajnë mënyrat e llogaritjes së kohës së punës, gjatë proceseve të prodhimit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e kontrollit të funksionimit të mjeteve, makinerive, pajisjeve, etj.
- Të shpjegojnë rëndësinë e matjeve dhe instrumenteve matëse.
- Të shpjegojnë mënyrat e zbatimit të planit të punimeve.
- Të shpjegojnë radhën e kryerjes së punimeve sipas urdhrit të punës.
- Të shpjegojnë mënyrat e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike.
- Të shpjegojnë rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit me specialistë të tjerë.
- Të argumentojnë rëndësinë e mbarëvajtjes së punës në ekip.
- Të shpjegojnë mënyrat e kontrollit të pastrimit dhe sistemimit të veglave dhe vendit të punës para, gjatë dhe pas punës.
- Të shpjegojnë llojet e dokumenteve për regjistrimin e proceseve të punës.
- Të përshkruajnë format e raportimit për ecurinë e punës.
- Të përshkruajnë drejtimit e karrierës dhe përshkrimet e punës në degën e mekanikës.
- Të analizojnë aspektet ligjore të sipërmarrjeve në degën e mekanikës.
- Të përshkruajnë standardet ndërkombëtare që veprojnë në degën e mekanikës.
- Të argumentojnë rëndësinë e etikës së komunikimit me profesionalizëm.
- Të përshkruajnë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit në degën e mekanikës.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Planifikimi dhe organizimi i punës në mekanikë”, kl.13 - 64 orë**

Tema 1	Veçoritë e mekanikës si degë e ekonomisë	2 orë
Tema 2	Llojet e sipërmarrjeve që veprojnë në kuadrin e mekanikës	3 orë
Tema 3	Organigrama e një ndërmarrjeje /reparti të prodhimit industrial	2 orë
Tema 4	Linjat e prodhimit dhe llojet e tyre	3 orë
Tema 5	Planifikimi dhe përzgjedhja e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të punës	2 orë
Tema 6	Planifikimi dhe përzgjedhja e burimeve njerëzore të nevojshme sipas kompetencave profesionale	2 orë
Tema 7	Kuadri ligjor dhe normativ që vepron në degën e mekanikës	3 orë
Tema 8	Standardet ndërkombëtare që veprojnë në degën e mekanikës	5 orë
Tema 9	Karrierat dhe përshkrimet e punësimeve në degën e mekanikës	3 orë
Tema 10	Mënyrat e llogaritjes së kohës së punës gjatë proceseve të prodhimit	3 orë
Tema 11	Organizimi i vendit të punës, urdhri i punës	3 orë
Tema 12	Mënyrat e zbatimit të planit të punimeve	4 orë
Tema 13	Kontrolli i funksionimit të mjeteve, makinerive, pajisjeve, etj	3 orë
Tema 14	Bashkëpunimi dhe koordinimi për mbarrëvajtjen e punës	4 orë
Tema 15	Kontrolli dhe mirëmbajtja e veglave dhe vendit të punës para, gjatë dhe pas punës	4 orë
Tema 16	Llojet e dokumenteve për regjistrimin dhe raportimin e proceseve të punës	4 orë
Tema 17	Rregullat e etikës profesionale dhe të komunikimit në një ndërmarrje mekanike	4 orë
Tema 18	Rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit në degën e mekanikës	5 orë
Tema 19	Vizitë në një ndërmarrje mekanike për njohjen me organizimin e punës në degën e mekanikës	5 orë

4. Lënda “Proceset e prodhimit në mekanikë” (L-26-757-25). Kl. 13–64 orë

- **Synimet e lëndës “Proceset e prodhimit në mekanikë”, kl.13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Proceset e prodhimit në mekanikë”, klasa 13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë rëndësinë dhe qëllimin e projektimit dhe llogaritjeve konstruktive për proceset e prodhimit në mekanikë.
- Të argumentojnë rëndësinë dhe përparësitë e përdorimit të programit “AutoCAD” (vizatimit me kompjuter) në proceset e prodhimit në mekanikë.
- Të realizojnë hapjen dhe ruajtjen e një vizatimi në “AutoCAD” duke përdorur komanda të ndryshme.
- Të përshkruajnë rëndësinë e përdorimit të primitivave grafike (vija, sistem koordinativ etj.) në programin “AutoCAD”.
- Të përshkruajnë rëndësinë e përdorimit të komandave të modifikimit (*array, mirror, explode* etj.) në programin “AutoCAD”.

- Të realizojnë ndërtimin grafik të blloqeve, vendosjen e dimensioneve në një vizatim, si dhe matjen e parametrave gjeometrikë në fletën elektronike.
- Të realizojnë procesin e printimit të vizatimeve në letër-*PLOT (Plotera)*.
- Të përshkruajnë makinat me drejtim të programuar numerik, ndërtimin dhe funksionimin e tyre.
- Të argumentojnë rëndësinë e përdorimit të programeve kompjuterike për punime në makina me drejtim të programuar numerik.
- Të shpjegojnë çfarë është analiza teknologjike e konstruksionit të një detali.
- Të realizojnë projektimin konstruktiv dhe vizatimin e punës së një detali.
- Të përcaktojnë llojin e gjysëm-fabrikatit që do të përdoret për prodhimin e detalit.
- Të përcaktojnë shtesat e punimit mekanik.
- Të realizojnë skicën dhe vizatimin e gjysëm-fabrikatit.
- Të përshkruajnë radhen e punimeve në proceset e prodhimit në mekanikë.
- Të përzgjedhin makinat, pajisjet, veglat e punës dhe instrumentet matëse e punuese të nevojshme për proceset e prodhimit në mekanikë.
- Të përcaktojnë regjimet e punës së makinave për punimin e detalit.
- Të plotësojnë kartat teknologjike për proceset e prodhimit.
- Të përshkruajnë automatizimin, rëndësinë dhe përdorimet e tij në proceset e prodhimit në mekanikë.
- Të shpjegojnë bllok-skemat dhe parimin e punës së sistemeve të komandimit automatik.
- Të përshkruajnë përdorimet e PLC-ve (Programming Logic Controller) në proceset e prodhimit në mekanikë.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Proceset e prodhimit në mekanikë”, kl. 13 – 64 orë**

Tema 1	Projektimi dhe llogaritjet konstruktive për proceset e prodhimit në mekanikë	2 orë
Tema 2	Rëndësia, veçoritë dhe epërsitë e përdorimit të programit <i>AutoCAD</i> (vizatimi me ndihmën e kompjuterit) në proceset e prodhimit në mekanikë	2 orë
Tema 3	Ndërfaqja e përdoruesit (ndërfaqja grafike, hapja dhe ruajtja e një vizatimi, komandat e ndryshme etj.). Praktikë për hapjen e faqes	3 orë
Tema 4	Njohja me primitivat grafike në <i>AutoCAD</i> (vija, sistemi koordinativ dhe sintaksa që përdoret në të, <i>arch</i> , <i>circle</i> , <i>line</i> etj.). Praktikë për primitivat grafike	3 orë
Tema 5	Njohja me komanda të modifikimit (<i>array</i> , <i>mirror</i> , <i>explode</i> , <i>break</i> , <i>align</i> , etj.). Praktikë për komandat e modifikimit	3 orë
Tema 6	Ndërtimi grafik i blloqeve, vendosja e dimensioneve dhe tekstit në një vizatim, matja e parametrave gjeometrikë në fletën elektronike. Praktikë për veprimet e mësipërme	3 orë
Tema 7	Nxjerrja e informacionit (printimi) në letër- <i>PLOT (Plotera)</i> . Praktikë për printimin	2 orë
Tema 8	Njohuri të përgjithshme për makinat me drejtim të programuar numerik, ndërtimi dhe funksionimi i tyre	3 orë
Tema 9	Rëndësia dhe përdorimi i programeve kompjuterike për punime në makina me drejtim të programuar numerik	4 orë
Tema 10	Analiza teknologjike e konstruksionit të detalit	2 orë

Tema 11	Projektimi konstruktiv i detalit dhe llogaritja projektuese	4 orë
Tema 12	Punimi i vizatimit të punës së detalit pas llogaritjeve projektuese	3 orë
Tema 13	Përzgjedhja e gjysmë-fabrikatit dhe përcaktimi i shtesave të punimit	2 orë
Tema 14	Përcaktimi i shtesave të punimit mekanik në proceset e prodhimit në mekanikë dhe përgatitja e skicës së gjysmë-fabrikatit	4 orë
Tema 15	Punimi i vizatimit të gjysmë fabrikatit	4 orë
Tema 16	Përcaktimi i radhës së punimeve në proceset e prodhimit në mekanikë	2 orë
Tema 17	Zgjedhja e makinave, pajisjeve dhe veglave të punës	2 orë
Tema 18	Zgjedhja instrumentave punuese dhe matëse	2 orë
Tema 19	Përcaktimi i regjimeve të punës për punimin e detalit	2 orë
Tema 20	Përgatitja e kartës teknologjike	4 orë
Tema 21	Automatizimi dhe përdorimet e tij në proceset e prodhimit në mekanikë	2 orë
Tema 22	Bllok-skema dhe parimi i punës i sistemeve të komandimit automatik	2 orë
Tema 23	Njohuri për PLC-të (Programming Logic Controller) dhe përdorimet e tyre në proceset e prodhimit në mekanikë	4 orë

5. Lënda “Detale makinash” (L-04-304-25). Kl. 13 – 64 orë

• Synimet e lëndës “Detale makinash“, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Detale makinash“, klasa 13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë qëllimin dhe rendesine e lëndës “Detale makinash”.
- Të analizojnë llojet e lidhjeve të detaleve, klasifikimin, veçoritë dhe përdorimin.
- Të kryejnë llogaritje të lidhjeve me ribatina.
- Të kryejnë llogaritje të lidhjeve me saldim.
- Të kryejnë llogaritje të lidhjeve me kiaveta dhe shliza.
- Të kryejnë llogaritje të lidhjeve me fileta.
- Të analizojnë llojet e transmesioneve mekanike, veçoritë, ndërtimin dhe përdorimin e tyre.
- Të kryejnë llogaritje të transmesioneve me fërkim.
- Të analizojnë transmesionet me rripa, llojet, veçoritë dhe përdorimin e tyre.
- Të kryejnë llogaritje të transmesioneve me rripa, të sheshtë dhe trapezoidalë.
- Të analizojnë llojet e pulexhave, ndërtimin dhe përdorimin e tyre.
- Të shpjegojnë llojet e transmesioneve me litar, ndërtimin dhe përdorimin e tyre.
- Të kryejnë llogaritje të transmesioneve me litar.
- Të shpjegojnë llojet e transmesioneve me zinxhir, ndërtimin dhe përdorimin e tyre.
- Të kryejnë llogaritje të transmesioneve me zinxhir.
- Të shpjegojnë llojet e transmesioneve me rrota cilindrike dhe konike, ndërtimin dhe përdorimin e tyre.
- Të kryejnë llogaritje të transmesioneve me rrota cilindrike, me dhëmbë të drejtë.
- Të kryejnë llogaritje të transmesioneve me rrota cilindrike, me dhëmbë të pjerrët.
- Të kryejnë llogaritje të transmesioneve me rrota konike, me dhëmbë të drejtë.
- Të përshkruajnë veçoritë e transmesioneve me burmë, llojet, veçoritë dhe përdorimin e tyre.
- Të njehsojnë përmasat kryesore të transmesioneve me burmë.
- Të përshkruajnë llojet dhe veçoritë e akseve dhe boshteve, si dhe përdorimin e tyre.
- Të përshkruajnë llojet dhe veçoritë e mbështetëseve të akseve dhe boshteve.
- Të përshkruajnë llojet e kushinetave, që përdoren në mbështetëset e akseve dhe boshteve.
- Të kryejnë llogaritje të ngarkesave në akse, boshte dhe mbështetëset e tyre.

- Të shpjegojnë llojet dhe veçoritë e sustave, ndërtimin dhe përdorimin e tyre.
- Të analizojnë lidhjet me xhunto (me fllanxhë, elastike, me fërkim), përdorimin dhe veçoritë e tyre.
- Të kryejnë llogaritje të lidhjeve me xhunto.
- Të përshkruajnë makinat ngritëse dhe transportuese, llojet, veçoritë dhe përdorimin e tyre.
- Të përshkruajnë elementët frenues dhe ndalues në makinat e ndryshme.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Detale makinash”, kl. 13 – 64 orë**

Tema 1	Hyrje në detalet e makinave.	2 orë
Tema 2	Njohuri të përgjithshme për lidhjet (bashkimet) e detaleve, llojet, veçoritë, përdorimi.	2 orë
Tema 3	Lidhjet e paçmontueshme, lidhjet me ribatina, llogaritja e tyre.	2 orë
Tema 4	Lidhjet me saldim, llojet, veçoritë dhe llogaritja e tyre.	3 orë
Tema 5	Lidhjet e çmontueshme, lidhjet me kiaveta dhe me shliza, llogaritja e tyre.	2 orë
Tema 6	Lidhjet me fileta, llojet, veçoritë, përdorimi dhe llogaritja e tyre.	2 orë
Tema 7	Njohuri të përgjithshme për transmisionet me fërkim, llojet, veçoritë, përdorimi.	2 orë
Tema 8	Llogaritja e transmiseve me fërkim me rrota cilindrike.	2 orë
Tema 9	Njohuri të përgjithshme për transmisionet me rripa, llojet, veçoritë, përdorimi.	2 orë
Tema 10	Llogaritja e transmiseve me rripa të sheshtë dhe trapezoidalë.	3 orë
Tema 11	Njohuri të përgjithshme për pulexhat, ndërtimi i tyre, rregullat e montimit.	2 orë
Tema 12	Njohuri të përgjithshme për transmisionet me litar, llojet, veçoritë, përdorimi dhe llogaritja e tyre.	2 orë
Tema 13	Njohuri të përgjithshme për transmisionet me zinxhir, llojet, veçoritë, përdorimi dhe llogaritja e tyre.	2 orë
Tema 14	Njohuri të përgjithshme për transmisionet me rrota të dhëmbëzuara, llojet, veçoritë dhe përdorimi. Raporti i transmesionit dhe rendimenti.	2 orë
Tema 15	Elementët gjeometrikë të rrotave cilindrike me dhëmbë të drejtë.	2 orë
Tema 16	Transmisionet me rrota cilindrike me dhëmbë të drejtë e të pjerrët. Elementët gjeometrike të transmesionit.	2 orë
Tema 17	Llojet dhe shkaqet e dëmtimit të rrotave me dhëmbë.	2 orë
Tema 18	Llogaritja e transmiseve me rrota cilindrike me dhëmbë të drejtë, njehsimi i forcave që veprojnë në dhëmbë gjatë transmetimit të lëvizjes, llogaritja e dhëmbit në përkulje dhe shtypje.	2 orë
Tema 19	Llogaritja e transmiseve me rrota cilindrike me dhëmbë të pjerrët, njehsimi i forcave që veprojnë në dhëmbë gjatë transmetimit të lëvizjes.	2 orë
Tema 20	Transmisionet me rrota konike me dhëmbë të drejtë, veçoritë dhe llogaritja e tyre. Njehsimi i raportit të transmesionit dhe këndeve në kulm për raste të ndryshme në transmesionet me rrota konike me dhëmbë të drejtë.	2 orë
Tema 21	Njehsimi i përmasave kryesore të rrotave konike me dhëmbë të drejtë.	2 orë
Tema 22	Njohuri të përgjithshme për transmisionet me burmë, llojet, veçoritë, përdorimi.	2 orë
Tema 23	Njehsimi i përmasave kryesore të transmiseve me burmë.	2 orë
Tema 24	Njohuri të përgjithshme për akset dhe boshtet, llojet, veçoritë, përdorimi dhe llogaritja e tyre.	2 orë
Tema 25	Njohuri të përgjithshme për mbështetëset e akseve dhe boshteve, llojet, veçoritë, përdorimi dhe rregullat e montimit.	2 orë

Emilij

Tema 26	Llogaritja e kushinetave rrëshqitëse dhe rrokullisëse.	2 orë
Tema 27	Njohuri të përgjithshme për sustat, llojet, veçoritë dhe përdorimi i tyre.	2 orë
Tema 28	Njohuri të përgjithshme për lidhjet me xhunto (me flanaxhë, elastike, me fërkim), përdorimi, veçoritë dhe llogaritja e tyre.	4 orë
Tema 29	Njohuri të përgjithshme për makinat ngritëse (vinçat) dhe transportuese (elevatore, ashensore, teleferiket), llojet, veçoritë dhe përdorimi i tyre.	2 orë
Tema 30	Pajisjet ndaluese dhe frenuese.	2 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli: “Prodhimi me cilësi i produkteve mekanike”

Kualifikimi: Mekanikë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kod	PRODHI ME CILËSI I PRODUKTEVE MEKANIKE	M-04-2212-25
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të projektuar e përcaktuar procesin teknologjik dhe për të prodhuar nyje të thjeshta mekanike në përdorimin e proceseve mekanike, si dhe aplikimin e praktikave, kontrollit të cilësisë, për të garantuar produkte të besueshme.	
Kohëzgjatja e modulit	64 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga kualifikimet profesionale të nivelit III të KSHK, të fushës “Mekanikë”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi projektin nyjen e thjeshtë mekanike. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të analizojë drejt qëllimin e përdorimit dhe funksionet që do të kryejë nyja mekanike që do të projektohet; - të analizojë drejt ngarkesat që do të përballojë dhe kushtet në të cilat do të punojë nyja mekanike që do të projektohet. - të analizojë drejt konstruksionin e nyjeve mekanike të ngjashme me nyjen mekanike që do të projektohet. - të përcaktojë materialet e duhura të elementeve të nyjes mekanike. - të përcaktojë drejt zgjidhjen konstruktive të nyjes mekanike që do të prodhohet. - të kryejë llogaritjen konstruktive (projektuese ose kontrolluese) të një detali të thjeshtë të nyjes përkatëse - të kryejë vizatimin e punës së nyjes mekanike, që do të prodhohet. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë. - Vlerësim i dokumentacionit teknik. - Vëzhgim me listë kontrolli RN 2 Nxënësi përcakton procesin teknologjik të prodhimit të nyjes së thjeshtë mekanike. Kriteret e realizimit:	

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të kryejë analizën e duhur teknologjike e konstruksionit të nyjes dhe të detaleve të saj.
- të përcaktojë llojet e duhura të gjysëm-fabrikateve për secilin nga detalet e nyjes.
- të përcaktojë shtesat e sakta të punimit mekanik për secilin nga detalet e nyjes.
- të përgatitë skicat e gjysëm-fabrikateve për secilin nga detalet e nyjes.
- të përcaktojë rradhën e duhur të kryerjes së operacioneve dhe elementeve të tyre për secilin nga detalet.
- të përcaktojë instrumentet punuese dhe matëse për secilin nga detalet e nyjes.
- të përcaktojë regjimet e duhura të punës për secilin nga detalet e nyjes.
- të përcaktojë makinat, pajisjet dhe veglat e punës.
- të përcaktojë mënyrën e duhur të montimit të elementeve të nyjes.
- të përgatitë kartat teknologjike të prodhimit të detaleve të nyjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim i dokumentacionit teknik.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi prodhon nyjen e thjeshtë mekanike.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të prodhimit të nyjes dhe të detaleve të saj.
- të përzgjedhë drejt gjysëm-fabrikatet për secilin nga detalet e nyjes.
- të përgatitë për punë makinat që do të përdoren për prodhimin e detaleve të nyjes mekanike.
- të përzgjedhë pajisjet, veglat dhe instrumentet punuese e matëse të duhura për prodhimin e detaleve të nyjes.
- të kryejë rregullimin e regjimeve të duhura të punës për prodhimin e detaleve të nyjes.
- të kryejë vendosjen e copave (gjysëm-fabrikateve) dhe instrumenteve punuese në makinat përkatëse.
- të kryejë operacionet e punës me makinat përkatëse.
- të kryejë punimet axhusterike, saldimet ose punimet e tjera (nëse është e nevojshme).
- të kryejë matje dhe kontrole të sakta të detaleve të nyjes gjatë prodhimit.
- të kryejë montimin e detaleve të nyjes.
- të kryejë provën e funksionimit të nyjes.
- të plotësojë dokumentacionin teknik të nyjes së prodhuar.
- të kryejë llogaritjet financiare të nyjes së prodhuar.
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës.

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë prodhimit të nyjes.

Instrumentet e vlerësimit

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Vlerësim i dokumentacionit teknik.

RN 4 Nxënësi kryen kontrollin përfundimtar të cilësisë.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të prodhimit të nyjes dhe të detaleve të saj.
- të kryejë kontrollin e përputhshmërisë së materialeve të përdorura, duke u bazuar në dokumentacionin teknik;
- të përzgjedhë drejt instrumentat matëse dhe pajisjeve të nevojshme për kryerjen e kontrollit përfundimtar të cilësisë.
- të analizojë manualët të instrumenteve matës dhe pajisjeve të nevojshme.
- të kryejë kontrollin dhe tarimin e instrumentave matëse sipas specifikave përkatëse të nyjes së prodhuar.
- të kryejë matjet e duhura për secilin detal përbërës së nyjes së prodhuar.
- të kryejë kontrollin e cilësisë së nyjes të montuar.
- të identifikojë parregullsitë e mundëshme të produktit të prodhuar;
- të marrë masa për korrigjimin e parregullsive të mundëshme të produktit të prodhuar;
- të plotësojë dokumentacionin teknik të kontrollit përfundimtar të cilësisë së nyjes së prodhuar.
- të tregojë kujdesin e duhur për instrumentat matëse dhe pajisjeve.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë procesit të kontrollit përfundimtar të cilësisë së nyjes së prodhuar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Vlerësim i dokumentacionit teknik.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin mekanik të shkollës ose në mjedise pune ku prodhohen nyje mekanike
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të projektimit dhe prodhimit të nyjeve të thjeshta mekanike.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për projektimin dhe prodhimin e nyjeve të thjeshta mekanike, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të punojnë në grup dhe të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për projektimin dhe prodhimin e nyjeve të thjeshta mekanike.

	– Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të theksohen shprehitë praktike të kontrollit të cilësisë së produktit përfundimtar. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit,, të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: – Mjedise të praktikës për punime mekanike. – Makina të ndryshme metalpunuese. – Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për projektimin dhe prodhimin e nyjeve mekanike. – Materiale të ndryshme (gjysëm-fabrikate) metalike. – Mjete për kryerjen e vizatimeve teknike. – Modele të nyjeve metalike të ndryshme. – Katalogë të nyjeve mekanike, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Punime të diagnostikimit në pajisjet dhe konstruksionet mekanike”

Kualifikimi: Mekanikë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME TË DIAGNOSTIKIMIT NË PAJISJET DHE KONSTRUKSIONET MEKANIKE	M-04-871-25
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të ndryshme diagnostikimi të çifteve kinematike, nyjeve dhe grupeve që ndodhen në pajisje dhe konstruksione mekanike, duke përdorur edhe instrumenta matëse dhe kontrolluese.	
Kohëzgjatja e modulit	64 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga kualifikimet profesionale të nivelit III të KSHK, të fushës “Mekanikë”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi kryen diagnostikime të çifteve kinematike me rrota të dhëmbëzuara. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të analizojë skicën ose vizatimin e çiftit kinematik me rrota të dhëmbëzuara, që do të diagnostikohet. - të përgatisë bangoprovën për punë. - të përzgjedhë drejt instrumentat kontrollues dhe matës. - të kryejë diagnostikimin e çiftit me rrota të dhëmbëzuara. - të përcaktojë shkakun e defektit. - të përcaktojë rrugën e eliminimit të defektit. - të dërgojë çiftin kinematik me rrota të dhëmbëzuara në repartin e riparimit. - të kryejë saktë kontrollin dhe matjet me instrumentat përkatëse. - të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës. - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit ,gjatë diagnostikimit të çiftit të rrotave të dhëmbëzuara. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi kryen diagnostikime të çifteve kinematike me bosht dhe kushineta rrëshqitëse dhe me kushineta rrokullisëse. Kriteret e realizimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë :	

- të analizojë skicën ose vizatimin e çiftit kinematik me bosht dhe kushineta rrëshqitëse që do të diagnostikohet.
- të përgatisë bangoprovën për punë.
- të përzgjedhë drejt instrumentat matëse dhe kontrolluese.
- të kryejë diagnostikimin e çiftit me bosht dhe kushineta rrëshqitëse ose kushineta rrokullisëse.
- të përcaktojë drejt shkakun e defektit.
- të përcaktojë rrugën e eliminimit të defektit.
- të dërgojë çiftin kinematik me bosht dhe kushineta rrëshqitëse ose kushineta rrokullisëse në repartin e riparimit.
- të kryejë saktë kontrollin dhe matjet me instrumentat përkatëse.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë diagnostikimit të çiftit me bosht dhe kushineta rrëshqitëse ose kushineta rrokullisëse.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen diagnostikime të transmesioneve me rripa dhe me zinxhirë.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të analizojë skicën ose vizatimin e transmesionit me rrip ose me zinxhir që do të diagnostikohet.
- të përgatisë bangoprovën për punë.
- të përzgjedhë drejt instrumentat kontrolluese dhe matëse.
- të kryejë diagnostikimin e transmesionit me rrip ose me zinxhir.
- të përcaktojë shkakun e defektit.
- të përcaktojë rrugën e eliminimit të defektit.
- të dërgojë transmesionin me rrip ose me zinxhir në repartin e riparimit.
- të kryejë saktë kontrollin dhe matjet me instrumentat përkatëse.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë diagnostikimit të transmesionit me rripa ose me zinxhirë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN4 Nxënësi kryen diagnostikime të nyjeve të një pajisjeje ose konstruksioni mekanik (motor elektrik, bashkuese, reduktor, etj.,)

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të analizojë skicën ose vizatimin e nyjes kinematike të pajisjes ose konstruksionit mekanik, që do të diagnostikohet.
- të përgatisë bangoprovën për punë.
- të përzgjedhë drejt instrumentet kontrolluese dhe matëse.
- të kryejë diagnostikimin e nyjes kinematike të pajisjes ose konstruksionit mekanik.
- të përcaktojë shkakun e defektit.
- të përcaktojë rrugën e eliminimit të defektit.
- të dërgojë nyjen kinematike të pajisjes ose konstruksionit mekanik, në repartin e riparimit.
- të kryejë saktë kontrollin dhe matjet me instrumentet përkatëse.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë diagnostikimit të nyjes kinematike të pajisjes ose konstruksionit mekanik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kryen diagnostikime të sistemeve hidro-pneumatike.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të analizojë skicën ose vizatimin e sistemit hidro-pneumatik, që do të diagnostikohet.
- të përgatisë bangoprovën për punë.
- të përzgjedhë drejt instrumentet kontrolluese dhe matëse.
- të kryejë kontrollin e elementeve të sistemit hidropneumatik (pompa, rezervuari, cilindrat, tubat, rakorderitë, rregullatorët, valvolat, treguesit e presionit, etj.,).
- të përcaktojë defektet e mundëshme dhe shkaqet e tyre.
- të përcaktojë rrugën e shmangies së defekteve.
- të dërgojë detalin apo nyjen kinematike të sistemit hidro-pneumatik, që do të riparohet, në repartin e riparimit.
- të kryejë saktë kontrollin dhe matjet me instrumentet përkatëse.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit, gjatë diagnostikimit të sistemit hidro-pneumatik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për

zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e diagnostikimit (riparimit) të shkollës ose në reparte të tjera ku kryhen punime riparimi.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve kryesore diagnostikuese që kryhen.

	– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të diagnostikimit në nyjet më kryesore të pajisjeve dhe konstruksioneve mekanike, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e diagnostikimit që kryejnë. – Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të diagnostikimit. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Mjedise të praktikës së diagnostikimit mekanik. – Bankoprova. – Pajisje dhe konstruksione të ndryshme mekanike. – Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje dhe kontrollin e çifteve të ndryshme kinematike. – Nyje dhe grupe të ndryshme mekanike. – Sisteme hidro-pneumatike – Skica dhe vizatime teknike të nyjeve, grupeve dhe pajisjeve mekanike. – Kataloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli: “Mirëmbajtje dhe riparime mekanike”

Kualifikimi: Mekanikë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MIRËMBAJTJE DHE RIPARIME MEKANIKE	M-04-2213-25
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të mirëmbajtjes dhe të riparimit makinerive e të pajisjeve të ndryshme; mekanike, elektromekanike dhe hidropneumatike të tilla si: makineri transportuese, elektromotorë, gjeneratorë, elektropompa, pompa vaji, shpërndarës, hidromotor, kompresor, etj.,	
Kohëzgjatja e modulit	32 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga kualifikimet profesionale të nivelit III të KSHK, të fushës “Mekanikë”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe të riparimit mekanik në pajisjet elektromekanike. Kriteret e realizimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë : - të analizojë skicën ose vizatimin (katalogun) e pajisjes elektromekanike. - të kryejë kontrollin pamor të pajisjes elektromekanike. - të përcaktojë shërbimet e mirëmbajtjes, që do t'i kryhen pajisjes elektromekanike. - të kryejë saktë kontrollin dhe matjet me instrumentat përkatëse. - të diagnostikojë parregullsitë e mundëshme të funksionimit të pajisjes elektromekanike. - të përcaktojë materialet dhe pjesët e këmbimit të nevojshme për shërbimet e mirëmbajtjes ose riparimit të pajisjes elektromekanike. - të përgatitë vendin e punës për mirëmbajtjen ose riparimin e pajisjes elektromekanike. - të përzgjedhë veglat, instrumentet matës dhe kontrollues. - të shkëpusë lidhjet elektrike të pajisjes elektromekanike. - të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes së nevojshme, me metodat e duhura, në detalet dhe nyjet e pajisjes elektromekanike - të kryejë riparimet dhe zëvendësimet e nevojshme të detaleve ose nyjeve të dëmtuara të pajisjes elektromekanike. - të rivendosë lidhjet elektrike të pajisjes elektromekanike.	

-
- të kryejë provën e funksionimit të pajisjes elektromekanike pas shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes ose riparimit të saj.
 - të plotësojë me kujdes dokumentacionin përkatës për shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes ose riparimeve të kryera.
 - të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit, gjatë shërbimeve të mirëmbajtjes ose riparimit të pajisjes elektromekanike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Vlerësim i dokumentacionit teknik.

RN 2 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe të riparimit mekanik në pajisjet hidropneumatike.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të analizojë skicën ose vizatimin (katalogun) e pajisjes hidropneumatike.
- të kryejë kontrollin pamor të pajisjes hidropneumatike.
- të përcaktojë shërbimet e mirëmbajtjes që do t'i bëhen pajisjes hidropneumatike.
- të kryejë saktë kontrollin dhe matjet me instrumentat përkatëse.
- të diagnostikojë parregullsitë e mundëshme të funksionimit të pajisjes hidropneumatike.
- të përcaktojë materialet dhe pjesët e këmbimit të nevojshme për shërbimet e mirëmbajtjes ose riparimit të pajisjes hidropneumatike.
- të përgatitë vendin e punës për mirëmbajtjen ose riparimin e pajisjes hidropneumatike.
- të përzgjedhë veglat, instrumentat matës dhe kontrollues
- të kryejë saktë kontrollin dhe matjet me instrumentat përkatëse.
- të kryejë saktë shërbimet e mirëmbajtjes së nevojshme, (vaxisjet, grasatimet, shtrëngimet, zëvendësimet e filtrave etj.) në pajisjen hidropneumatikë.
- të kryejë riparimet dhe zëvendësimet e nevojshme të detaleve ose nyjeve të dëmtuara të pajisjes hidropneumatike.
- të kryejë provën e funksionimit të pajisjes hidropneumatike pas shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes ose riparimit të saj.
- të plotësojë me kujdes dokumentacionin përkatës për shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes ose riparimeve të kryera.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit, gjatë shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjes hidropneumatike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Vlerësim i dokumentacionit teknik.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin mekanik të shkollës ose në mjedise pune ku mirëmbahen dhe riparohen pajisje elektromekanike dhe hidropneumatike.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të mirëmbajtjes e riparimit të pajisjeve të ndryshme elektromekanike dhe hidropneumatike.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për matjen, kontrollin, mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve elektromekanike dhe hidropneumatike, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të punojnë në grup dhe të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve elektromekanike dhe hidropneumatike.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedisë të praktikës për punime mekanike.
 - Pajisje të ndryshme elektromekanike dhe hidropneumatike (elektromotorë, gjeneratorë, elektropompa, pajisje elektroshtëpiake, pompa vaji, shpërndarës, kompresor, hidromotor etj.).
 - Instrumente matëse dhe kontrolluese.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve, makinave dhe instrumenteve të nevojshme për mirëmbajtje dhe riparime mekanike.
 - Materiale për mirëmbajtje mekanike
 - Pjesë këmbimi për pajisjet elektromekanike dhe hidropneumatike.
 - Dokumentacion teknik, katallogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli: “Komunikimi dhe etika profesionale në mekanikë”

Kualifikimi: Mekanikë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	KOMUNIKIMI DHE ETIKA PROFESIONALE NË MEKANIKË	M-38-2214-25
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të zbatuar teknikat e komunikimit dhe të etikës profesionale në marrëdhëniet me eprorët, kolegët dhe të tretët gjatë punës.	
Kohëzgjatja e modulit	32 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga kualifikimet profesionale të nivelit III të KSHK, të fushës “Mekanikë”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi zbaton teknikat e komunikimit gjatë punës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të zbatojë rregullat bazë të komunikimit verbal me eprorët dhe kolegët; - të zbatojë rregullat bazë të komunikimit jo verbal me eprorët dhe kolegët; - të shkëmbejë informacion për problemet dhe të reja të ditës, sipas rastit; - të koordinojë saktë punën në grup me teknikët dhe specialistët e tjerë në veprimtarinë profesionale mekanike; - të përdorë teknologji të reja të informimit dhe komunikimit gjatë punës; - të respektojë hierarkinë, sipas organigramës në ndërmarrje; - të zbatojë kodin e komunikimit në punë. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi zbaton kodin e etikës gjatë punës. Kriteret e realizimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë : - të zbatojë kodin e etikës në punë; - të japë zgjidhje për problematikat gjatë punës në mënyrë etike dhe profesionale; - të përdorë terminologji teknike dhe profesionale gjatë punimeve në ndërmarrje mekanike;	

- të ruajë kofidencialitetin etik të procesit të prodhimit, sipas rregullore së brendshme të ndërmarrjes;
- të zbatojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare, etj, gjatë punës në ndërmarrje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin mekanik të shkollës ose në mjedise pune ku punohet.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të komunikimit dhe etikës profesionale në punë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për zbatimin e komunikimit dhe etikës profesionale në punë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për zbatimin e komunikimit dhe etikës profesionale në punë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të theksohen shprehitë praktike të zbatimit të komunikimit dhe etikës profesionale në punë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjediset të praktikës për punime mekanike.
 - Kompjuter, fotokopje, shërbim interneti dhe programe kompjuterike për të përgatitur dokumentet e nevojshme.
 - Dokumentacion teknik, katalogë, manuale, udhëzuesat, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Bashkëpunim me biznese prodhuese mekanike
-

X. Programi Orientues i provimit përfundimtar

Në përfundim të nivelit të IV i KSHK në kualifikimin profesional “**Mekanikë**”, nxënësit i nënshtrohen Provimit Përfundimtar të praktikës profesionale të integruar, në zbatim të udhëzimit nr. 15, datë 26.04.2020 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në Arsimin dhe Formimin Profesional”.

Programi orientues për provimin përfundimtar të praktikës së integruar të kualifikimit profesional “**Mekanikë**”, **Niveli IV i KSHK** përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 13-të, që i përket këtij niveli.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqendrohen në ato kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësuesit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për prindërit, ky program jep informacionin për vëllimin e punës, që kërkohet të bëjnë fëmijët e tyre dhe ndihmon në caktimin e një regjimi të përshtatshëm ditor për ta.

Për drejtuesit e arsimit profesional të të gjitha niveleve, ky program krijon mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të nxënësve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet, duke zhvilluar testime përmbledhëse.

Gjatë punës me këtë program kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimin përfundimtar, është e rëndësishme që herë pas here instruktorët të zhvillojnë testime të nxënësve me teste praktike, që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin profesional “**Mekanikë**”, **Niveli IV i KSHK** është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
----	--------------------------	-----------------	-------

1	Të realizojë: - hapat e procesit teknologjik të punimit mekanik të detaleve - realizimin e prodhimit të detaleve, përcaktimin e hapave të procesit teknologjik - të montimit dhe realizimin e montimit të nyjes të thjeshtë mekanike. Të kryejë veprimtari praktike për prodhimin e produkteve mekanike të sigurta dhe cilësore. kryejë vlerësimin e sigurisë dhe cilësisë së produktit gjatë prodhimit	Detyra 1. “Montimi i nyjes së thjeshtë mekanike”	30
2	Të realizojë punime të ndryshme të: - diagnostikimi të çifteve kinematike me rrota të dhëmbëzuara, - diagnostikimi të çifteve kinematike me bosht dhe kushineta rrëshqitëse dhe me kushineta rrokullisëse. - diagnostikimi të transmesioneve me rripa dhe me zinxhir dhe grupeve që ndodhen në pajisje dhe konstruksione mekanike	Detyra 2. “Punime të diagnostikimit në pajisjet dhe konstruksionet mekanike”.	40
3	Të realizojë punime të mirëmbajtjes dhe të riparimit të makinerive dhe pajisjeve të ndryshme mekanike, elektromekanike dhe hidropneumatike (makineri transportuese, elektromotorë, gjeneratorë, elektropompa, pompa vaji, shpërndarës, hidromotor, kompresor, etj.)	Detyra 3 “Mirëmbajtje dhe riparime mekanike”	30
Shuma			100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve në “poste pune”, grupe pune ose në mënyrë individuale, në bazën prodhuese ose laboratorin e shkollës e mjedise të simuluar..

- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Udhëzimin nr. 15. Datë 26.04.2019 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në arsimin dhe formimin profesional” në fuqi.
- Në çdo detyrë respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë domosdoshmërisht të përfshira në vlerësim.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësim dhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet anëtarëve të komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara. Komisioni i vlerësimit duhet të hartojë paraprakisht pyetjet për bashkëbisedimin profesional.
- Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrjen e komisionit duke u testuar/vlerësuar në një nga proceset e punës për çdo detyrë, kjo edhe për shkak të kohës së kufizuar 3 orë të provimit praktik.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme. Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për produktin përfundimtar.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përgatisë udhëzuesin e përmbushjes për nxënësit, ku do të jepen hapat për realizimin e detyrës përkatëse.

Për realizimin e **detyrës 1** do të shfrytëzohen mjediset e bazës prodhuese dhe laboratorit të shkollës.

Komisioni i provimit do të përgatisë paraprakisht disa teza, ku secila prej tyre do të përmbajë realizimin e detalizimit, përcaktimin e hapave të procesit teknologjik të punimit mekanik të detaleve, realizimin e prodhimit të detaleve, përcaktimin e hapave të procesit teknologjik të montimit dhe realizimin e montimit të nyjes të thjeshtë mekanike.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Makina të ndryshme metalpunuese.
- Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për projektimin dhe prodhimin e nyjeve mekanike.
- Materiale të ndryshme (gjysëm-fabrikate) metalike.
- Mjete për kryerjen e vizatimeve teknike.
- Modele të nyjeve metalike të ndryshme.
- Dokumentacion teknik, katalog, manuale, udhëzues.

Gjithashtu do të përmbajë përcaktimin e hapave të për prodhimin e produkteve mekanike të sigurt dhe cilësor, të kryejë vlerësimin e sigurisë dhe cilësisë së produktit gjatë prodhimit

Nxënësit do të angazhohen në veprimtari konkrete pune duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në çdo proces pune në bazën prodhuese dhe në laborator. Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli, e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.

Detyra 2 do të realizohet në repartin e diagnostikimit (riparimit) të shkollës , ose në aktivitete private për punime riparimi.

Për realizimin e **detyrës 2** “Punime të diagnostikimit në pajisjet dhe konstruksionet mekanike”, nxënësit kryejnë punime të diagnostikimit të çifteve kinematike, nyjeve dhe grupeve që ndodhen në pajisje dhe konstruksione mekanike duke përdorur drejt instrumentet kontrollues dhe matës.

Për realizimin e detyrave, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Pajisje dhe konstruksione të ndryshme mekanike.
- Komploti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje dhe kontrollin e çifteve të ndryshme kinematike.
- Nyje dhe grupe të ndryshme mekanike.
- Skica dhe vizatime teknike të nyjeve, grupeve dhe pajisjeve mekanike.
- Dokumentacion teknik, katalog, manuale, udhëzues.
- Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin të diagnostikimit. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Detyra 3 do të realizohet, në repartin mekanik të shkollës, ose në aktivitete private ku mirëmbahen dhe riparohen pajisje elektromekanike dhe hidropneumatike.

Për realizimin e **detyrës 3** “Mirëmbajtje dhe riparime mekanike” nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Mjedisë të praktikës për punime mekanike.
- Pajisje të ndryshme elektromekanike dhe hidropneumatike (elektromotorë, gjeneratorë, elektropompa, pajisje elektroshtëpiake, pompa vaji, shpërndarës, kompresor, hidromotor etj.).
- Instrumente matëse dhe kontrolluese.
- Komploti i veglave, pajisjeve, makinave dhe instrumenteve të nevojshme për mirëmbajtje dhe riparime mekanike.
- Materiale për mirëmbajtje mekanike
- Pjesë këmbimi për pajisjet elektromekanike dhe hidropneumatike.
- Dokumentacion teknik, katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

Nxënësit realizojnë punime të mirëmbajtjes të pajisjeve të ndryshme. Nxënësit realizojnë punime të riparimit të pajisjeve të ndryshme.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Rekomandohet që secila prej detyrave të mësipërme të ketë listë kontrolli më vete dhe në fund të realizimit të tyre, të bëhet tabela përmbledhëse e pikëve dhe notave përkatëse.